



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr. 1 , datë 28.03.2012

PËR

**“MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË REZERVËS UJORE PËR HIDROENERGJI
NGA SUBJEKTI DEVOLL HYDROPOWER”**

Në mbështetje të neneve 6, shkronjat “ç dhe ë”, 11, 12, 16 dhe 18, paragrafi i parë, të ligjit Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, ligjit Nr. 10083, datë 23.02.2009 “Për miratimin e kontratës së konçesionit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER sh.a, si bashkëkonçesionare për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në RSH”, Vendimit Nr. 27, datë 19.01.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim të rezerves ujore për hidroenergjii nga subjekti Devoll Hydropower në kaskadën e lumit Devoll per HEC si më poshtë:

HEC Nr. 1 Moglice

1. Prurja mesatare	Q mes = 22.00 m ³ /sek
2. Prurja llogaritese	Q llog = 65.00 m ³ /sek
3. Kuota e vepres se marrjes	H = 610 m m.n.d.
4. Kuota max. e nivelit te ujit	H = 650 m m.n.d.

HEC Nr. 2 Kokel

1. Prurja mesatare	Q mes = 26.92 m ³ /sek
2. Prurja llogaritese	Q llog = 73.00 m ³ /sek
3. Kuota e vepres se marrjes	H = 310 m m.n.d.
4. Kuota max. e nivelit te ujit	H = 350 m m.n.d.

HEC Nr.3 Banje

1. Prurja mesatare	Qmes = 47.10 m ³ /sek
2. Prurja llogaritese	Qllog = 95.00 m ³ /sek
3. Kuota e vepres se marrjes	H = 146 m m.n.d.
4. Kuota max. e nivelit te ujit	H = 175 m m.n.d.

2. Ngarkohen ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kryetari i Këshillit të Basenit përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SALI BERISHA

Fatmir MËDIU



Zevendes kryetar i K.K.U
dhe

Ministër i Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit të Ujërave




Bujar NISHANI

Ministër i Brendshëm




Ridvan BODE

Ministër i Financave




Nasip NAÇO

Ministër i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës




Petrit VASILI

Ministër i Shëndetësisë




Genc RULI

Ministër i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit



Sokol OLLDASHI

Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit



**RELACION
PER
PROJEKTVENDIMIN
“MIRATIMI I LEJES PËR PËRDORIM TË REZERVËS UJORE PËR HIDROENERGJI
NGA SUBJEKTI DEVOLL HYDROPOWER”**

Qëllimi i realizimit të këtij vendimi është miratimi i lejes për përdorim të rezervës ujore për hidroenergjë nga subjekti Devoll Hydropower në bazë të propozimit të Keshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin, nëpërmjet vendimit Nr. 5, datë 19.12.2012 “Për përdorimin me leje të rezervës ujore nga subjekti Devoll Hidropower”.

Baza ligjore për hartimin e këtij vendimi janë nenet 6, shkronjat “ç dhe ë”, 11, 12, 16 dhe 18, paragrafi i parë, të ligjit Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, ligjit Nr.10083, datë 23.02.2009 “Për miratimin e kontratës së konçesionit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER sh.a, si bashkëkonçesionare për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në RSH”, Vendimi Nr. 27, datë 19.01.2007 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar.

Me Vendimin Nr. 6, datë 30.06.2007, Keshilli Kombëtar i Ujit ka dhënë “Miratimin në parim të përdorimit për hidroenergjë të rezervave ujore në lumin Devoll”.

Konçesionari (EVN, Statkraft dhe Devoll Hydropower sh.a) ka lidhur një marrëveshje konçesionare me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr. 10083, datë 23.02.2009 “Për miratimin e kontratës së konçesionit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER sh.a, si bashkëkonçesionar, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në RSH”, i ndryshuar.

Kjo veprë konsiderohet e një rëndësie kombëtare në aspektin e rritjes së kapaciteteve energjetike dhe ndikimit që ka në zhvillimin social-ekonomik të vendit. Gjithashtu, duke qenë se kontrata konçesionare është miratuar me ligjin Nr. 10083, datë 23.02.2009 në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë është e nevojshme që leja e ujit të merret me vendim të KKKU.

Në këtë mënyrë, kërkesa e shoqërisë konçesionare se bashku me materialet përmbledhëse depozitohet në K.B.U përkatëse, e cila ia kalon për shqyrtim të gjithë materialin STKKU, ku ky i fundit përparat dokumentacionin për mbledhjen e KKKU në lidhje me dhenien e lejes për përdorim të rezervës ujore për hidroenergjë nga subjekti kërkuar.

Me vendimin Nr. 5, datë 19.12.2011, K.B.U Shkumbin në pikën 1 të tij vendos: “T’ia kalojë dokumentacionin e subjektit Devoll Hydropower Sekretariatit Teknik të Keshillit Kombëtar të Ujit për kompetencë, në lidhje me dhenien e lejes për përdorim të ujit nga KKKU”.

Nga dokumentacioni teknik rezulton se do të shfrytëzohet rrjedha e lumit Devoll nga kuota 650 m m.n.d. deri në kuotën 98 m m.n.d. nëpërmjet ndërtimit të tre HEC-ve të vendosura në formë kaskade, me parametrat si më poshtë:

HEC Nr. 1 Moglice

1. Prurja mesatare	Q mes = 22.00 m ³ /sek
2. Prurja llogaritese	Q llog = 65.00 m ³ /sek
3. Kuota e vepres se marrjes	H = 610 m m.n.d.
4. Kuota max. e nivelit te ujit	H = 650 m m.n.d.
5. Fuqia e instaluar	N = 171.2 MW
6. Prodhimi mesatar vjetor	E = 445.0 GWh

HEC Nr. 2 Kokel

1. Prurja mesatare	Q mes = 26.92 m ³ /sek
2. Prurja llogaritese	Q llog = 73.00 m ³ /sek
3. Kuota e vepres se marrjes	H = 310 m m.n.d.
4. Kuota max. e nivelit te ujit	H = 350 m m.n.d.
5. Fuqia e instaluar	N = 36.2 MW
6. Prodhimi mesatar vjetor	E = 92.0 GWh

HEC Nr.3 Banje

1. Prurja mesatare	Qmes = 47.10 m ³ /sek
2. Prurja llogaritese	Qllog = 95.00 m ³ /sek
3. Kuota e vepres se marrjes	H = 146 m m.n.d.
4. Kuota max. e nivelit te ujit	H = 175 m m.n.d.
5. Fuqia e instaluar	N = 64.6 MW
6. Prodhimi mesatar vjetor	E = 252.0 GWh

Nga studimi ne teresi i dokumentacionit teknik dhe ligjor rezulton qe materiali eshte i plote.

Bazuar ne sa me sipër, koncesionari kerkon te pajiset me leje per perdorimin e rezerves ujore per prodhim hidroenergji ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Mendojme se ky vendim do t'i sherbeje zbatimit te politikave te rendesishme dhe strategjike te ndjekura nga Qeveria Shqiptare, ne rritjen e kapaciteteve prodhuese te energjise elektrike me ane te burimeve hidrike.

Fatmir *MEDIU*

Zevendes kryetar i K.K.U.
dhe
Ministër i Mjedisit, Energjitikës
dhe Administrimit të Ujërave



